



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc, që përbëhet prej tri (3) njësive gjeneruese; HEC III Kovaqic me kapacitet prej 2*1500 kW, HEC IV Kamenic afër Kaçanikut me kapacitet prej 2*1750 kW dhe HEC V Doganaj me kapacitet prej 2*1675 kW në total prej 9.85 MW, të gjitha në komunën Kaçanikut, të datës 18.12.2014, të shoqërisë “Matkos Group” sh.p.k., me adresë rruga “Nazim Gafurri” nr. 289, KK Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_489_2012 i datës 24 dhjetor 2012, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht **deri me 24 qershor 2015**.

A r s y e t i m

- ZRRE, me datë 29.04.2011 nga shoqëria “**Matkos Group**” sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, , në Lumin Lepenc, që përbëhet prej tri (3) njësive gjeneruese; HEC III Kovaqic me kapacitet prej 2*1500 kW, HEC IV Kamenic afër Kaçanikut me kapacitet prej 2*1750 kW dhe HEC V Doganaj me kapacitet prej 2*1675 kW në total prej 9.85 MW, të gjitha në komunën Kaçanikut.
- Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqëria “**Matkos Group**” sh.p.k., do t’i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.



- ZRRE me datë 18.12.2014 nga shoqëria **“Matkos Group” sh.p.k.**, ka pranuar Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, , në Lumin Lepenc, që përbëhet prej tri (3) njësive gjeneruese; HEC III Kovaqic me kapacitet prej 2*1500 kW, HEC IV Kamenic afër Kaçanikut me kapacitet prej 2*1750 kW dhe HEC V Doganaj me kapacitet prej 2*1675 kW në total prej 9.85 MW, të gjitha në komunën Kaçanikut, edhe për një afat shtesë sipas legjislacionit në fuqi.
 - Shoqëria **“Matkos Group” sh.p.k.**, në kërkesë e saj ka sqaruar se: pas marrjes së pëlqimit nga Komuna e Kaçanikut, ka përgatitur tërë dokumentacionin e nevojshëm me datë 17.05.2012, ka aplikuar në MMPH për Pëlqim Mjedisor për ndërtimin e HV-ve, në Lumin Lepenc të Komunës së Kaçanikut.
 - MMPH pas pranimit të kërkesës, ka filluar procedurat ligjore, dhe në bazë të kërkesës, ka organizuar vizitën në teren si dhe me datë 25.07.2012 ka mbajtur Dëgjim Publik me palët e interesuara. MMPH pas kësaj ka sjellur vendimin nr. 12/12/1326/2-ZSP/101/12 të datës 29.03.2013 me të cilën ka refuzuar kërkesën e shoqërisë **“Matkos Group” sh.p.k.**, me arsyetim se është konstatuar se në lokacionet në të cilat planifikohet të ndërtoj HC-të, u është dhë pëlqimi Mjedisor dy kompanive tjera që kanë aplikuar më herët.
 - Shoqëria **“Matkos Group” sh.p.k.**, ka sqaruar se për shkak të refuzimit të kërkesës për pëlqim mjedisor, ka ushtrua padi kundër vendimit të MMPH nr. 12/12/1326/2-ZSP/101/12 të datës 29.03.2013 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Ka sqaruar se deri më sot gjykata, nuk ka caktuar ende seancë për shqyrtim të bazueshmërisë së padisë dhe kërkesëpadiisë, kështu që janë në pritje të këtij gjykimi dhe sjelljes së vendimit në bazë të padisë së ushtruar.
 - Andaj, bazuar në këtë që u tha më lartë, ka sqaruar se aplikuesi nuk ka pasur mundësi që afatin e përcaktuar me pikën IV të diapozitivit të Vendimit V-489-2012 të datës 24 dhjetor 2012, të përmbush detyrimet e cekura dhe me dokumentacion të paraparë të aplikon për lëshuarën e autorizimit Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, dhe mbi këtë bazë ka kërkuar që të merren parasysh arsyetimet e paraqitura më lartë, dhe me këtë ka kërkuar zgjatjen e afatit plotësimin e kërkesave që dalin nga neni 14 dhe 15 i Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesat e tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm për ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
 - ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar ato dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V. Shoqëria **“Matkos Group” sh.p.k.**, duhet të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, , në Lumin Lepenc, që përbëhet prej tri (3) njësive gjeneruese; HEC III Kovaqic me kapacitet prej 2*1500 kW, HEC IV Kamenic afër Kaçanikut me kapacitet prej 2*1750 kW dhe HEC V Doganaj me kapacitet prej 2*1675 kW në total prej 9.85 MW, të gjitha në komunën Kaçanikut, deri me datën **24 qershor 2015** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.



VI. Pas skadimit të afatit të cekur më lartë, Vendimi V-489-2012 i datës 24 dhjetor 2012 mbi Njoftimi për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.

VII. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar